



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 599/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për shkak të thyerjes të heshtjes zgjedhore, në seancën e panelit të mbajtur me 07.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuëse (BIRN), kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 300 (treqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 04. 11. 2013 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga BIRN, në të cilën theksohet se me datën 02.11.2013 deputetja e PDK-së Ganimete Musliu ka thyer heshtjen zgjedhore duke bërë fushatë të hapur përmes postimit dhe publikimit të fotografisë të një anëtarë të PDK-së për të votuar për të, andaj me këtë rast sipas parashtrësimit të ankesës ky veprim bie ndesh me dispozitat e LZP-së

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDK, me datën 05.11.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 06.11.2013, ora 10:00. Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga PDK-ja, në të cilën përgjigje theksohet pretendimet se gjoja është thyer heshtja zgjedhore janë të pabazuara pasi që kjo pikë e këtij neni është shumë e përgjithësuar dhe nuk nënkupton edhe rrjetet e tyre personale të komunikimit dhe se nuk mund të trajtohen si media elektronike dhe se po të konsideroheshin këto veprime si shkelje, atëherë këtë shkelje e kanë bërë pothuajse të gjithë kandidatet dhe të gjithë anëtarët e të gjitha partive politike pa dallim, dhe se këto raste PDK-ja i konsideron si tendencioze ndaj personaliteteve të PDK-së.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të bashkangjitura shkresës së lëndës shihet qartë se si deputetja e PDK-së Ganimete Musliu me datën 02 nëntor 2013 gjatë heshtjes zgjedhore ka bërë postimin e fotografisë të një kandidati të PDK-së për zgjedhjet lokale, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 36.1 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë që njëzetekatër (24) orë para hapjes së qendrave të voimit për hedhjen e votes e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mështetesve ose kandidateve të tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfardo mënyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Andaj duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës PZAP-i vlerëson se subjekti politik PDK në këtë rast ka thyer kodin e mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, shkelje për të cilën parashihet shqiptimi i dënimit me gjobë, pasi që shkelje të natyres së tillë ka kryer edhe më pare gjë që konsiderohet si recidivist. Andaj mbi këtë bazë si dhe në kuptim të nenit 36.1 pika b) dhe nenit 118.1 lidhur me nenin 120 paragrafi 1 pika (c) të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 599/2013 më datën 07.11.2013.

Kryesuesi i Panelit

Hasan Shala

Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*